



Primitur / Dorezuar Prilbjen / Predato Received / Delivory	01-09-2022	viti god year	2
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUMSHOK	5072/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.593/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.593/2022 të datës 05.07.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë: rruga [redacted] kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike “masë disiplinore-vërejtje me shkrim”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si bazuar ankesa më numër A.nr.593/2022 e datës 05.07.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. Shfuqizohet Vendimi me numër protokolli 671/22 i datë 22.06.2022 i Udhëheqësit për Siguri të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan.

III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit, duke e hequr masën disiplinore ndaj ankuesit nga dosja personale.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit [redacted] i punësuar në Shërbimin Korrektues i Kosovës sipas Kontratës së punës të datës 01.08.2014 në pozitë “Mbikëqyrës i lartë” në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan”, me datë 22.06.2022 Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë/Udhëheqësi për Siguri në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, ka nxjerr Vendim me numër protokolli 671/22 përmes të cilit i ka shqiptuar masën disiplinore “vërejtje” me arsyetimin se ankuesi me datë 06.06.2022 ka parashtruar ankesë tek Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës, pa e njoftuar

mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë, respektivisht ankuesi nuk e ka përfillur organin kompetent dhe ka anashkaluar eprorët me ushtrimin e ankesës.

Ankuesi kundër Vendimit me numër protokoll 671/22 të datës 22.06.2022, ka parashtruar ankesë me datë 05.07.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i tij me rastin e shqiptimit të vërejtjes me shkrim, nuk ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, dhe propozon që vërejtja me shkrim të shfuqizohet si pa ligjshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 07.07.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimin Korrektues të Kosovës. Më datë 19.07.2022 Njësia e personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.08.2022 ka nxjerrë Vendimin me VK.nr.82/2022 për vazhdimin e afatit të ankesës me numër Anr.593/2022 të datë 05.07.2022, edhe për 10 dite pune

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e regjistruar me datë 05.07.2022 e parashtruar nga ankuesi me numër protokoll 3901/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokoll 671/22 të datës 22.06.2022; Përgjigje në ankesë e datës 19.07.2022 nr. protokoll 4191/2022, me shkresat e lëndës; Kontrata e punës e datës 01.08.2014; Përshkrim i detyrave të punës i datës 03.01.2020; Kërkesë për prova shtesë e datës 18.08.2022 E-mail i datës 18.08.2022 përgjigje sipas kërkesës për prova shtesë nga Njësia e personelit, duke bashkangjitur dy vlerësimet e rezultateve në punë të ankuesit; Ankesa e date 06.06.2022 drejtuar tek Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; E-maili i datës 19.08.2022 drejtuar Njesisë së Personelit ne SHKK; E-maili i datës 19.08.2022 -përgjigja e Njesisë së Personelit drejtuar Këshillit; E-maili i datës 30.08.2022 për prova shtesë drejtuar Njesisë së Personelit ne SHKK; E-maili i datës 01.09.2022 - përgjigja e Njesisë së Personelit drejtuar Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura në lëndë të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës ka konstatuar se ankuesi më datë 06.06.2022 ka parashtruar ankesë tek Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, lidhur me siç thotë parregullsitë në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan duke pretenduar që i është ndërruar vendi i punës pa ndonjë vendim të shkruar, është larguar nga zyra që ka pasur nga presioni që i ka bërë mbikëqyrësi i ndërrimit, ndërsa zyra i është uzurpuar nga mbikëqyrësi i larë në kohen kur ishte në pushim duke ja larguar gjërat e tij nga zyra të cilat edhe pse i ka kërkuar nuk i ka as sot, andaj siç thekson ai në ankesën e tij këto gjëra janë demotivuese për të dhe tërë stafin. Kolegji po ashtu ka konstatuar ankuesi ankesën e datës 06.06.2022 drejtuar Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës e ka parashtruar përmes Shefit për Siguri të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan ndërsa e ka njoftuar apo në C.C e ka vendosur edhe Drejtorin e Qendrës së Paraburgimit në Gjilan.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton ankesa e datës 06.06.20202 e paraqitur nga ankuesi tek Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës ka të bëjë me marrëdhënien e tij të punës e duke marr për bazë që Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës është personi përgjegjës i tërë Shërbimit Korrektues të Kosovës duke përfshirë të gjitha qendrat dhe institucionet korrektuese. Bazuar në këtë Kolegji i'u referua nenit 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë"*.

Andaj duke u bazuar në dispozitat e nenit 7 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesi më ankesën e datës 06.06.2022, nuk ka bërë asnjë veprim jo ligjor ndaj mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë apo edhe ndaj Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, rrjedhimisht sipas kësaj ankuesi nuk ka bërë shkelje disiplinore sepse me ankesën e datës 06.06.2022 drejtuar Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës ankuesi i ka njoftuar edhe Drejtorin e Qendrës së Paraburgimit në Gjilan dhe Shefin për Siguri të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, ku ky i fundit si mbikëqyrës i tij i drejtpërdrejtë e ka pranuar në e-mailin e datës 01.09.2022 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës se ankuesi ankesën e ka dërguar përmes e-mailit dhe përmes atij e-maili kanë qenë të njoftuar respektivisht të vendosur ne C.C andaj Kolegji konstaton se me parashtrimin e kësaj ankese nuk ka pasur asnjë sjellje të parregullt ndaj mbikëqyrësit të tij të drejtpërdrejt, gjegjësisht ankuesi nuk ka bërë asnjë veprim jo ligjor dhe se pretendimi i ankuesit është i qëndrueshëm dhe i bazuar.

Andaj lidhur me ligjshmërinë e Vendimit me numër protokolli 671/22 të datë 22.06.2022 të Udhëheqësit për Siguri të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se tek rasti i ankuesit nuk janë plotësuar kushtet për ekzistimin e elementeve disiplinore të përcaktuar me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*, elemente këto që duhet plotësuar kumulativisht në mënyrë që të ekzistoj përgjegjësi disiplinore, rrjedhimisht mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në mënyrë të gabuar ka konstatuar që ankuesi ka bërë shkelje të lehta të ndërlidhura me nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.2 dhe 4.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rrjedhimisht në mënyrë të gabuar ka përdorur faktet dhe argumentet kundër ankuesit, andaj masën disiplinore ndaj ankuesit e ka bërë në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ka vepruar në kundërshtim me nenin 45, nenin 46 paragrafi 4, nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 48 paragrafi 1, nenin 50 paragrafi 2 të



Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, sepse vendimin për masën disiplinore ndaj ankuesit e ka arsyetuar në kundërshtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, gjegjësisht me nenin 48 paragrafi 1 dhe të 2, andaj sa i përket pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji konstaton se të gjitha pretendimet janë të bazuar, ndërsa Vendimi me numër protokolli 671/22 i datë 22.06.2022 i Udhëheqësit për Siguri të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në kuptim të dispozitivit të këtij vendimi, Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës janë të obliguara që të heqin masën disiplinore ndaj ankuesit nga dosja personale e ankuesit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitave të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.593/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

MALSORE GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Drejtorin e Qendrës së Paraburgimit në Gjilan dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.